



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

PARASHTRIME

“Në lidhje me çështjen (JR) nr. 39/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Elona Alvora”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori, **z. Adnan Xholi** (me autorizim).

Objekti: Parashtrime të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancën gjyqësore të datës 24.6.2025, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit me nr. 538, datë 7.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **znj. Elona Alvora**.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: 24. 6. 2025.

Përpara: GJYKATËS KUSHTETUESE

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

Faqe 1 nga 16

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykues

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit!

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vijim të njoftimit për depozitimin pranë tij të akteve të kërkuara për efekt të hetimit gjyqësor në gjykimin konkret, pas konsultimit paraprak me dokumentacionin voluminoz, me shkresën nr. ***/** Prot., datë **.6.2025 ka përcjellë shkresën e gjyqtarit kryesues të trupit gjykues të çështjes (JR) nr. 39/2022, datë 7.9.2022, me anë të së cilës janë përcjellë kopje të disa prej akteve të fashikujve penalë, dërguar respektivisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Pas shqyrtimit të akteve të administruara, në raport me shkaqet e ankimit, marrë në konsideratë volumin e akteve, duke rezervuar të drejtën për tu shprehur në bisedimet përfundimtare, **parashtrojmë** gjetjet si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me **kallëzimin penal regjistruar me nr. ***, viti 2017**, të shtetasit *** për kryerjen e veprës penale “*Ndërtim i paligjshëm*”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dhe “*Pushtimit të tokës*” neni 200 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 9.8.2022, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këto çështje: (i) në drejtim të verifikimit nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, të filluar në muajin korrik 2017 deri aktualisht¹, janë apo jo në përmbushje të standardeve të nenit 73 pika 2 të ligjit 96/2016, i ndryshuar, përsa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime; (ii) gjithashtu, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë², si dhe mënyrës së zbatimit të nenit 326 “Pezullimi i hetimeve” të Kodit të Procedurës Penale.

1.1. Referuar akteve të administruara lidhur me materialin kallëzues regjistruar me nr. ***, viti 2017, rezulton se subjektit të rivlerësimit më datë **.7.2017 i është caktuar për ndjekje ky material kallëzues. Më datë **.7.2017 subjekti i rivlerësimit ka marrë **vendimin për mosfillimin e procedimit penal** për të cilin drejtuesi i seksionit në rubrikën *qëndrimi i drejtuesit të seksionit ka bërë shënimin “mund të orientohet hetimi dhe në drejtim të nenit 199/a”*.

¹ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit datë **.4.2022, f. 22, statusi i çështjes është: *vijon të jetë në fazën e hetimit paraprak*.

² Nga aktet në dosje të Komisionit konstatohet se subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës **.2.2021 shprehet se më datë **.03.2018 është urdhëruar fillimi i *procedimit penal për hetimin e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal*, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr. ***/** Prot., datë **.2.2021 konfirmon se *përsa i përket procedimit penal nr. **/2018 në hetim është pezulluar nga viti 2020 fashikulli hetimor ndodhet në Komisariatin e Policisë Himarë*.

1.2. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesi shtetasi *** **. Më datë **.12.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. *** ka vendosur **pranimin e ankimit penal**, shfuqizimin e vendimit të mosfillimit, urdhërimin e prokurores që të procedojë me regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të parashikuara në pjesën përshkruese - arsyetuese të këtij vendimi. Gjykata ndër të tjera arsyeton se [...] *Së pari nga ana e organit të akuzës duhet të ishin pyetur në cilësinë e personave që kanë patur dijeni për veprën penale shtetasi *** **, punonjësit e IMT Bashkia Himarë... (të cilët rezultojnë të kenë përpiluar procesverbalin nr. 1...) si dhe persona të tjerë që mund të identifikohen në varësi të hetimit, që mund të tregojnë rrethana të nevojshme për hetimin. Së dyti nga ana e organit të akuzës duhet të ishte proceduar me këqyrjen e vendit të ngjarjes Së treti duhet të ishte proceduar me kryerjen e një akti ekspertimi topografik sipas nenit 178 të Kodit të Procedurës Penale ... Së katërti me sekuestrimin dhe më pas kqyrjen e të gjithë praktikës administrative të ndjekur nga IMT Bashkia Himarë në lidhje me ankimin e paraqitur nga shtetasi *** **. [...] Gjithashtu [...] vetëm pas kryerjes së veprimeve hetimore të sipërcituara hetimore, organi i akuzës do të jetë në gjendje të arrijë në një përfundim më të drejtë dhe objektiv në lidhje me faktin nëse ndodhemi përpara veprave penale të kallëzuara nga ana e shtetasit *** ** dhe nëse po, në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal si dhe individualizimin e autorit apo autorëve të tij, duke paraqitur në çdo rast, kërkesë gjykatës për pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykim sipas dispozitave të reja procedurale [...].*

1.3. Kundër këtij vendimi të gjykatës ka ushtruar **ankim subjekti i rivlerësimit** në cilësinë e prokurorit të çështjes. Më datë **.2.2018 Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë **.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

1.4. Subjekti i rivlerësimit më datë **.5.2018 ka mbajtur *procesverbal këqyrje* të dosjes gjyqësore të vendimit nr. ***, datë **.12.2017 duke marrë 20 fletë fotokopje të njehsuara me origjinalin, më datë **.7.2018 ka nxjerrë aktin *urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore* me afat deri në datën **.9.2018, më datë **.10.2018 ka nxjerrë aktin *vendim për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit*, më datë **.4.2019 ka nxjerrë aktin *urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore*, si dhe më datë **.8.2020 ka nxjerrë aktin *urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore*.

1.5. Subjekti i rivlerësimit më datë **.11.2020 bazuar në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale ka marrë vendim **për pezullimin e hetimeve** për procedimin penal

sepse autori i veprës nuk njihet dhe në pikën 4 të këtij vendimi ka vendosur [...] *4.Fashikulli i procedimit penal të dërgohet në Komisariatit e Policisë Himarë, me qëllim që policia të mbledhë informacion të nevojshëm në kuadrin e procedimit policor, i cili hapet në rastin e pezullimit të procedimit penal. Nëse mbledhet informacion (në lidhje me faktet dhe rrethanat objekt hetimi, si dhe personin e mundshëm, policia gjyqësore të bëjë referimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për t'u administruar në formën e marrjes së provave sipas procedurave të përcaktuara në K.Pr.Penale [...]*

1.6. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit për periudhën nga data ****7.2017** kur i është ngarkuar ndjekja e materialit kallëzues deri më datë ****11.2020** kur ka marrë vendimin e pezullimit të hetimit nuk ka ndërmarrë në mënyrë logjike hetimin edhe pse ka patur detyra të qarta nga vendimet gjyqësore që kanë kontrolluar ushtrimin e ndjekjes penale nga ana e saj. Marrë në konsideratë faktin se çështja objekt kallëzimi i përket ngjarjes së muajit **qershor 2017** dhe referimi i kallëzimit penal përmban dokumentacion që përmban të dhëna të dobishme për hetimin duket e paefektshme marrja e vendimit të pezullimit më datë ****11.2020** si dhe vazhdimi i kësaj gjendje të procedimit edhe më datë ****4.2022** sipas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit paraqitur në Komision.

1.7. Pezullimi i hetimit pa kryer veprime që kanë qenë të nevojshme që në fillim të hetimit, bën që hetimi në tërësi të karakterizohet nga mangësi serioze, duke mos qenë në gjendje të vërtetonte faktet, të identifikonte në afat dhe plotësisht përgjegjësit dhe t'i ndëshkonte ata sipas ligjit penal. Për shkak të mangësive të veprimeve hetimore në kuptim të përshtatshmërisë, shpejtësisë dhe kujdesit të nevojshëm, autorët e veprës penale, përfshirë edhe atë të kallëzuar, eventualisht i shmangen drejtësisë. Po ashtu, mosidentifikimi dhe mandej mosmarrja në kohë e të gjitha provave të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes, ka çuar në kufizimin më pas të mundësive për zbulimin e plotë të rrethanave të ngjarjes si dhe të autorëve të saj. Për më tepër, ndonëse prokuroria dispononte disa të dhëna rreth personave të mundshëm të përfshirë në krim dhe për motivet e tij, ajo nuk rezulton të ketë ndjekur një linjë të qartë hetimi.

1.8. Në rastin konkret evidentohet mungesa e një përgjigjeje efektive nga organi i ndjekjes penale për identifikimin, kapjen dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për kryerjen e veprave penale, çka është thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe parandalimin e akteve të paligjshme.

2. Në lidhje me **kallëzimin penal regjistruar me nr. ***, viti 2015**, të shtetasit *** për kryerjen e veprës penale *“Falsifikimi i dokumenteve”* parashikuar nga neni 186 i

Kodit Penal, dhe “*Mashtrimi*” parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 9.8.2022, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë çështje për sa i përket: (i) evidentimit të veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit që kanë ndikuar në mungesën e hetimeve, vonesat e tejzgjatura kohore dhe përfundimit të hetimit penal, si dhe mosrespektimi në kohë të detyrave të lëna nga gjykata; (ii) këto rrethana të konstatuara disa herë edhe nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm penal, vlerësojmë se duhen parë si mangësi lidhur me aftësinë profesionale dhe ato organizative të subjekti të rivlerësimit.

2.1. Referuar akteve të administruara lidhur me materialin kallëzues regjistruar *me nr. 566, viti 2015*, rezulton se subjektit të rivlerësimit më datë ****2.2015** i është caktuar për trajtim ky material kallëzues për të kryer verifikime lidhur me kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Më datë ****3.2015** subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për *mosfillimin e procedimit penal*, i ankimuar nga shtetasi *******.

2.2. Më datë ****11.2015** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ******* ka vendosur *rrëzimin e kërkesës së ankuesit*.

2.3. Gjykata e Apelit Vlorë më datë ****06.2017** pas ankimit të kallëzuesit, me vendimin nr. ******* ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. *******, datë ****11.2015** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, prishjen e vendimit datë ****03.2015** të Prokurorisë dhe urdhërimin e organit procedues për vazhdimin e hetimeve. Gjykata e Apelit ndër të tjera arsyeton se [...] *organi procedues gabon kur e konsideron mosmarrëveshjen mes kallëzuesit e të kallëzuarit si një marrëdhënie juridike civile, duke mos analizuar kushtet dhe rrethanat në të cilën ka lindur kjo mosmarrëveshje. Mashtrimi si një vepër penale e drejtuar kundër marrëdhënieve juridike të vendosura për të mbrojtur pasurinë, padyshim që sjell edhe pasoja materiale duke përbërë shkak për lindjen e detyrimit civil. Por është detyra e organit procedues për të hetuar dhe sqaruar nëse kjo mosmarrëveshje ka lindur nga shpërdorimi i besimit apo përdorimi i gënjeshtërs nga njëra palë për ta detyruar palën tjetër në kryerjen e sjelljes në mirëbesim [...] gjithashtu [...] nga organi procedues nuk është kryer asnjë hetim në lidhje me ekzistencën e vendimit për prishjen e banesës së kallëzuesit ndërkohë që ishte në proces legalizimi, rrethanat në të cilat është prishur objekti, të cilat do të tregonin nëse vërtet është përdorur presioni dhe më pas shpërdorimi i besimit nga ana e të kallëzuarit për ta detyruar kallëzuesin në prishjen e banesës [...].* Subjekti i rivlerësimit më datë ****10.2017** ka nxjerrë aktin urdhër për *delegimin e veprimeve hetimore* ku në faqen 2 të tij shkruan se është i nevojshëm të *regjistrohet procedimi penal* dhe më datë ****2.2018** ka nxjerrë urdhër tjetër për delegimin e

veprimeve hetimore, dhe më datë ****11.2018** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë *për pushimin e çështjes*.

2.4. Më datë ****2.2019**, Gjykata me vendimin nr. *******, ka vendosur **rrëzimin e kërkesës për pushimin e çështjes kthimin e akteve prokurores, znj. Elona Alvora me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit**, ky vendim ankimohet nga subjekti i rivlerësimit. Më datë ****3.2019** Gjykata e Apelit Vlorë lë në fuqi vendimin nr. *******, datë ****2.2019** të Gj. Rr. Gj. Vlorë. Subjekti i rivlerësimit më datë ****5.2019** ka nxjerrë aktin urdhër *për rifillimin e hetimit të procedimit penal* si dhe me dokumentin e datës ****7.2019** me lëndë *“informim dhe dhënie mendimi për kërkesën për përjashtim”* drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, nuk jep pëlqimin për zëvendësimin nga kjo çështje, pas kërkesës për përjashtim të bërë nga kallëzuesi ***** *****. Më datë ****02.2020** subjekti i rivlerësimit nxjerr aktin *“urdhër për delegimin e veprimeve hetimore”* më datë ****06.2020** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë *për pushimin e çështjes*. Më datë ****06.2021** Gjykata me vendimin nr. ******* ka vendosur *mospranimin e kërkesës së Prokurorisë duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve detajuar në pjesën arsyetuese të këtij vendimi për rrëzimin e kërkesës për pushimin e çështjes kthimin e akteve prokurores znj. Elona Alvora me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit*.

2.5. Gjithashtu, në fashikull gjenden edhe disa akte procedurale të nxjerra nga një tjetër prokuror i cili më datë ****1.2025** i cili, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me **“kërkesën për pushimin e çështjes”** dhe arsyeton se për veprën penale të *“Mashtrimit”* parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal duke qenë se veprimet e pretenduara janë kryer në vitin 2005 ato janë **tej afatit të parashikuar nga neni 66 gërma “ç” e Kodit Penal** dhe përsa i përket punonjësve të policisë ndërtimore Vlorë rezulton se kanë konsumuar veprën penale të *“Shpërdorimit të detyrës”*, pasi nga ana e tyre nuk është respektuar procedura ligjore gjatë prishjes së objekti të shtetasit ***** *****, **por duke qenë se kanë kaluar mbi 10 vjet ndjekja penale nuk mund të vijojë**.

2.6. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, evidentohen mangësitë profesionale sipas atyre çështjeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 9.8.2022.

3. Në lidhje me **procedimin penal me nr. *****, **viti 2017**, filluar me dërgimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë të vendimit civil nr. *******, datë ****10.2017** si dhe mbi referimin e kallëzimit penal nga shtetasi ***** ***** për kryerjen e veprës penale

“Falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 9.8.2022, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë çështje për sa i përket: (i) verifikimit nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale të filluar në muajin dhjetor 2017 deri aktualisht³, janë apo jo, në përmbushje të standardeve të nenit 73 pika 2 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime; (ii) gjithashtu, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë⁴.

3.1. Referuar akteve të administruara lidhur me *procedimin penal me nr. ****, viti 2017, rezulton se:

3.1.1. Më datë ****11.2017** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë i dërgon Prokurorisë Vlorë vendimin civil me nr. *****, datë ***10.2017* ku në pikën 4 dhe 5 të tij është vendosur: [...] *4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore të bëjë shënimin “e falsifikuar” mbi aktin e cituar në pikën “2” të dispozitivit të këtij vendimi, shënim i cili realizohet vetëm pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë. 5. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë*. Në këtë vendim Gjykata ndër të tjera arsyeton [...] *u konkludua se akti Libri themeltar i pasurisë së paluajtshme i cili i referohet vendimit nr.***, datë **01.1953 të Komitetit Ekzekutiv të K.P. të Rrethit Vlorë është falsifikuar pasi në përmbajtjen e tij ka të dhëna kontradiktore, sipas të cilës rezulton se pasqyrohet shtetëzimi i banesës me kubaturë 15x12x3 ndërkohë që sipërfaqja e saj shënohet 3300 m² dhe më poshtë rezulton se sipërfaqja prej 3300 m² është kopësht. Dukshëm evidentohet një sipërfaqe tepër e madhe në raport me banesën prej vetëm 180 m² referuar të dhënave 15x12. Akti i referohet shtetëzimit të një banese, ndërkohë që sipërfaqen e banesës e paraqet 3300 m² më poshtë shënon sipërfaqen e kopshtit 3300 m². Rezulton se Vendimi nr.***, datë ***.01.1953 i Komitetit Ekzekutiv të K.P. të Rrethit Vlorë ka disponuar vetëm për shtetëzimin e një banese në favor të *** kundrejt vlerës përkatëse, por kurrësi nuk rezulton të trajtohet me këtë vendim shtetëzimi i ndonjë sipërfaqe trualli 3300 m²[...].*

3.1.2. Më datë ****12.2017** subjektit të rivlerësimit i është caktuar për trajtim material kallëzues regjistruar me nr. ***** viti 2017. Më datë ****12.2017** ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale *“Falsifikimi i dokumenteve”* parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, dhe me datë ****12.2017** ka nxjerrë urdhrin për

³ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit datë ***4.2002*, f. 14, kjo çështje është ende në proces.

⁴ Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton se urdhri për rifillimin e hetimit paraprak mban datën ***12.2020*, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është i datës ***6.2020*, ndërkohë nuk ka informacion mbi kohën e marrjes së këtij vendimi nga Prokuroria Vlorë.

materialin kallëzues regjistruar me nr. ***, viti 2017 me kallëzues shtetasin *** ***. Me vendimin e datës **.12.2017 subjekti i rivlerësimit ka vendosur bashkimin e procedimeve penale me nr. ***, të vitit 2017 dhe procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017 në një procedim të vetëm, më datë **.12.2017 i ka dërguar Gjykatës kërkesën për pushimin e çështjes. Më datë **.1.2018 subjekti ka nxjerrë urdhrin *për delegimin e veprimeve hetimore* dhe më datë **.10.2019 oficeri i policisë gjyqësore ka hartuar relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017.

3.1.3. Më datë **.12.2019 subjekti i është drejtuar gjykatës me **kërkesën për pushimin e çështjes**, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë më datë **.3.2020 me vendimin nr. ***, ka vendosur *pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes*.

3.1.4. **Gjykata e Apelit Vlorë** më datë **.6.2020 pas ankimit të kallëzuesit, me vendimin nr. ** ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.3.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë për vazhdimin e hetimeve brenda një afati 3 mujor sipas detyrave në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Subjekti i rivlerësimit më datë **.12.2020 ka nxjerrë aktin *urdhër për rifillimin e hetimeve* me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë. Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë më datë **.3.2022 në përgjigjen drejtuar Komisionit shprehet se për këtë procedim penal ***nuk ka ende një vendimarrje të prokurorit*** pasi është në vijim faza e hetimit paraprak për detyrat e lëna nga gjykata.

3.1.5. Në shkresën nr. ***/**/ Prot., datë **.6.2025, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sqarohet se: *Lidhur me procedimin nr. ***/2017 sa i përket vendimit nr. *** datë **.3.2020 rezulton se është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë duke kthyer aktet prokurorisë për vazhdimin e hetimeve. Pas përfundimit të hetimeve prokuroria e ka sjellë çështjen për pushim procedimi dhe Gjykata e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me vendimin nr. *** datë **.6.2021 ka disponuar përsëri për kthimin e akteve prokurorisë. Rezulton se më datë **.2.2025 dosja është sjellë përsëri nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, **për pushim procedimi** dhe është regjistruar me nr. *** akti, **aktualisht në gjykim**, bashkëlidhur së cilës ndodhen edhe aktet e prokurorisë të vendosura në dispozicion me këtë shkresë.*

3.2. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, evidentohen mangësitë profesionale sipas atyre çështjeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 9.8.2022.

4. Në lidhje me **procedimin penal me nr. ***, viti 2015** me kallëzues shtetasit *** dhe *** në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 9.8.2022, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë çështje si vijon (i) nga aktet e administruara dhe përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të jenë dhënë përgjigje bindëse mbi arsyet, veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me ecurinë e procedimit penal dhe përmbushjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin nr. ***, datë **.6.2018; (ii) nga momenti i rifillimit të hetimit penal, mbeten të paqarta veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nevoja e tyre e shtrirë në një kohë relativisht të gjatë, prej tetorit 2018 deri në datë **.2.2022, moment në të cilin subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka përpiluar kërkesën për pushimin e çështjes dhe se tashmë ajo ndodhet për shqyrtim në gjykatë⁵.

4.1. Nga aktet e konsultuara rezulton sa vijon:

4.1.1. Subjektit të rivlerësimit me procesverbalin (mbi hedhjen e shortit manual) të datës **.9.2018 i është caktuar vazhdimi i hetimeve për një çështje të filluar në vitin 2016 për të cilën është disponuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë të datës **.6.2018 me nr.***, i cili ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Gjykata e Apelit Vlorë pasi cakton detyra të hollësishme për organin e prokurorisë arsyeton [...] *detyrat e caktuara nga gjykata si më sipër do ti shërbejnë sqarimit të rrethanave të faktit të pretenduara në kallëzim nëse prokura e datës **.12.2008 është e falsifikuar dhe nëse shtetasi *** ka përdorur apo jo dokumente të falsifikuara si dhe nëse veprimet e tij ka realizuar apo jo veprën penale të mashtrimit të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal në dëm të trashëgimtarëve pronarë të përfaqësuar nga personat e besuar kallëzues në shitjen e pasurive duke nxjerrë përfitime në emrin e vet personal në dëm të interesave të tyre [...].*

4.1.2. Subjekti i rivlerësimit më datë **.10.2018 ka nxjerrë urdhrin për rifillimin e hetimit paraprak për hetimin e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pas rreth 15 muajsh më datë **.1.2020 ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datat **.2.2020 dhe **.2.2020 ka nxjerrë vendime për këqyrje dokumentesh, në datat **.10.2020, **.11.2020, **.1.2021, **.03.2021, **.5.2021 janë fiksuar në procesverbal marrja e të dhënave nga persona që kanë dijeni për veprën penale, më datë **.10.2021 është nxjerrë vendimi për këqyrjen e dokumenteve dhe më datë **.11.2021 është mbajtur procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve. Më datë **.2.2022 oficeri i policisë gjyqësore ka përgatitur

⁵ Referuar përgjigjeve të dhëna nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, dërguar me emailin e datës **.4.2022.

Relacion mbi faktet, provat dhe mënyrën e përfundimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2015. Më datë **.2.2022 subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesën për pushimin e çështjes.

4.1.3. Referuar shkresës me nr. ***/** Prot., datë **.6.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë rezulton se aktet e procedimit penal me vendim të gjykatës ***i janë kthyer Prokurorisë*** pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

4.2. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, evidentohen mangësitë profesionale sipas atyre çështjeve parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 9.8.2022.

5. Në lidhje me ***procedimin penal me nr. ***, viti 2020*** me kallëzues shtetasin *** ***, regjistruar kallëzimi penal me nr. ***, viti 2019 për veprën penale të “*Falsifikimit të dokumenteve*” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale*” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 9.8.2022, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë çështje si vijon (i) në gjendjen që janë aktet, më së paku, rrethanat tregojnë për një qëndrim të subjektit të cilat ndikojnë në vlerësimin e indikatorëve matës të kriterit të aftësive profesionale, referuar ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar apo dhe në një vlerësim të përgjithshëm sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016; (ii) në kushtet që vendimi nr. ***/2019 i Gjykatë së Apelit Vlorë, nuk rezulton të jetë ndryshuar nga Gjykata e Lartë, detyrat dhe orientimet e lëna në të kanë qenë detyruese për zbatim nga organi procedues, në këtë rast, nga subjekti i rivlerësimit (iii) këto detyra rezultojnë të pa përmbushura edhe sipas vendimit nr. **, datë **.3.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë; (iv) mos respektimi i autoritetit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit duket se ka sjellë zvarritje të panevojshme të hetimit të çështjes, në cenim ndaj të drejtave dhe interesat e qytetarit kallëzues.

5.1. Nga aktet e konsultuara rezulton sa vijon:

5.1.1. Subjekti i rivlerësimit më datë **.7.2019 ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Më datë **.10.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.*** ka vendosur mospranimin e ankimit të shtetasit *** ndaj vendimit të mosfillimit. Më datë **.12.2019 Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të datës **.7.2019 regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit ndër të tjera arsyeton [...] *pretendimet e kallëzuesit kanë nevojë për veprime hetimore për t’u verifikuar, pasi pretendohet falsifikim material i aktit për*

pasojë me qëllim verifikimin e tyre është e nevojshme regjistrimi i procedimit penal dhe kryerja e veprimeve hetimore për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve” e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit prokuroria duhet të verifikojë ekzistencën e dosjes përkatëse në institucionin që administron aktet e ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, Agjencia e Trajtimit të pronave, të verifikohen elementët grafikë të pretenduara nga kallëzuesi, duke krahasuar këtë vendim me vendime të të njëjtës periudhë të të njëjtit institucion, dhe në rast se vlerësohet e nevojshme kryerja e një akti ekspertimi grafik si dhe veprime të tjera hetimore sipas vlerësimit të prokurorisë [...].

5.1.2. Subjekti i rivlerësimit më datë ****5.2020** ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, më datë ****7.2020** ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore sipas detyrave të lëna nga gjykata. Më datë ****11.2020** i është drejtuar me kërkesë për pushimin e çështjes gjykatës.

5.1.3. Më datë ****1.2021** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin me nr. ******* ka vendosur **kthimin e akteve** organi të prokurorisë dhe po në dispozitiv ka urdhëruar [...] kryerjen e akt ekspertimit në lidhje me përmabjtjen dhe nënshkrimet për vendimin nr. ******, datë ****6.1995**, protokolluar me numër ***** Prot.**, të KKKP Vlorë, dokumentit të administruar pranë ATP-së dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe atij të paraqitur nga pala dhe të nënshkruar vetëm nga Kryetari i Komisionit (fq. 26 e fashikullit të mosfillimit) [...].

5.1.4. Më datë ****3.2021** pas ankimit të prokurorit Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ******, ka disponuar **lënien në fuqi** të vendimit me nr. *******, datë ****1.2021**.

5.1.5. Më datë ****3.2022** Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të vendos në dispozicion fashikullin hetimor të procedimit penal nr. *******, të vitit 2020 me kallëzues shtetasin ******* *******. Më datë ****3.2022** subjekti i rivlerësimit nxjerr aktin për rifillimin e hetimit paraprak, me datë ****4.2022** nxjerr urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, më datë ****4.2022** subjekti nxjerr vendimin për sekuestrimin e dokumenteve realizuar sipas procesverbalit të datës ****5.2002**, më datë ****5.2022** oficeri i policisë gjyqësore ka marrë vendimin për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit teknik, ku në pjesën konstatuese përshkruan se [...] *për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të këtij procedimi penal bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë është e nevojshme kryerja e një ekspertimi teknik grafik të dokumentit [...]* detyrë kjo e lënë fillimisht më datë ****12.2019** nga Gjykata e Apelit Vlorë. Më datë ****7.2022** oficeri i policisë gjyqësore përgatit relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit

penal nr. ***, të vitit 2020 ku në fund të tij thotë [...] nga sa më lartë **ndodhemi** para elementëve të veprës penale “falsifikimi i dokumenteve” vepër e parashikuar nga 186 të Kodit Penal. Vendimi nr. *** datë **.06.1995 i KKKP Vlorë, nr. *** Prot., datë **.07.1995 rezultoi i falsifikuar pasi nënshkruar (firma) e një prej anëtarëve të Komisionit shtetases *** nuk duhet të jetë nënshkruar prej saj.[...]. Subjekti më datë **.9.2022 ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore ku në pikën 2 të tij urdhëron të pyetet shtetasja *** për të sqaruar më tej konkluzionin jo kategorik të ekspertit kundrejt nënshkrimeve të saj. Më tej në datat **.5.2023 dhe **.3.2025 oficeri i policisë gjyqësore përgatiti relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2020.

5.1.6. Referuar shkresës me nr. ***/* Prot., datë **.6.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë rezultoi se dosja ndodhet **ende në gjykim**, nuk ka një vendim përfundimtar.

5.2. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, evidentohen mangësitë profesionale sipas atyre çështjeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 9.8.2022.

6. Në lidhje me **procedimin penal me nr. ***, viti 2015** me kallëzues shtetasin *** për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal dhe të “Pushtimit të tokës” parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 9.8.2022, është parashtruar nevoja e hetimit nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, të filluar në muajin korrik 2015 të përfunduar me vendimin e formës së prerë datë **.8.2021, janë në përmbushje të standardeve të nenit 73 pika 2 të ligjit 96/2016, i ndryshuar, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime dhe kohëzgjatjes.

6.1. Nga aktet e konsultuara rezultoi sa vijon:

6.1.1. Subjektit të rivlerësimit sipas formularit për trajtim të materialit kallëzues nënshkruar nga Zëvendës drejtuesi i Prokurorisë i ka kaluar për trajtim kallëzimi i regjistruar me nr. ***, datë **.7.2015. Po më datë **.7.2015 subjekti ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Pushtimit të tokës” të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, më datë **.9.2015 ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, më datë **.9.2015, **.10.2015, **.2.2016 janë fiksuar në procesverbal marrja e të dhënave nga persona që kanë dijeni për veprën penale, më datë **.3.2016 oficeri i policisë gjyqësore përgatiti relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, më datë **.5.2016 është mbajtur procesverbal për

marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, më datë ****5.2016** subjekti nxjerr vendimin për pushimin e procedimit penal.

6.1.2. Më datë ****6.2017** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ******* ka vendosur pranimin e ankimit të shtetasit ******* ndaj vendimit të pushimit duke shfuqizuar vendimin e pushimit dhe urdhërimin e organit të prokurorisë të vazhdojë hetimet për procedimin penal me nr. *******, të vitit 2015, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë më datë ****11.2017**, me vendimin nr. *******. Gjykata në vendimin e datës ****6.2017** ndër të tjera arsyeton: [...]Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pavarësisht se gjatë hetimeve ka ardhur në dijeni se nga ana e shoqërisë “*******” sh.p.k., janë kryer punime ndërtimi në pronën e shtetasit *******, punime të kryera në kundërshtim me projektin e miratuar nga ana e Autoritetit Rrugor Shtetëror dhe në dëm të pronës private të shtetasit *******, duke zënë nga kjo pronë 610 m/2 (fakte që rezultojnë nga ekspertimi teknik i kryer gjatë një gjykimi civil), nuk ka hetuar në lidhje me këtë fakt. Prokuroria nuk ka kryer një akt ekspertimi me qëllim që të përcaktojë volumin e punimeve të kryera, llojin e punimeve, nëse punimet e kryera nga shoqëria “*******” sh.p.k., konsiderohen ndërtime dhe nëse janë kryer në përputhje me projektin e miratuar nga ana e Autoritetit Rrugor Shtetëror. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pavarësisht se ka ardhur në dijeni që prona e shtetasit *******, nga ndërtimet e kryera prej shoqërisë “*******” sh.p.k., ka pësuar dëmtime, në rrethana kur gjatë hetimit kanë rezultuar indicie që punimet janë kryer në kundërshtim me projektin e miratuar nga Autoritetit Rrugor Shtetëror, nuk ka ekspertuar vlerën e këtij dëmtimi për të verifikuar nëse pronës së shtetasit ******* i është shkaktuar dëm e për të konkluduar më pas në lidhje me normat penale të shkelura nga shoqëria ndërtuese. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është bazuar në arritjen e konkluzioneve të saj duke u mbështetur vetëm në dokumentacionin e dorëzuar nga kallëzuesja gjatë hetimit ndërsa nuk ka kryer verifikimin e këtij dokumentacioni. Nuk ka kërkuar dokumentacionin e pronësisë së ankuesit në ZVRPP Vlorë; Nuk ka kërkuar nga Autoritetit Rrugor Shtetëror projektin e ndërtimit me objekt “Sistemimin, Asfaltim rrugët lidhëse të Bregdetit Loti 1”; Nuk ka kërkuar kontratën nr. ******/**, datë ****07.2009**, me objekt “Sistemim asfaltim rrugët lidhëse me bregdetin (*****-*****) Loti 1”, nënshkruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*******” sh.p.k., dhe “*******” sh.p.k.; Nuk ka kërkuar vendimin e marrë nga mbledhja e Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar e datës ****1.2013**, ku është marrë në shqyrtim propozimi për shtesë kontrate për objektin “Sistemim Asfaltim rrugët lidhëse të Bregdetit Loti 1” dhe është ndryshuar projekti. Pavarësisht përcaktimit juridik që i ka dhënë kallëzuesi faktit penal të kallëzuar prej tij prokuroria është e detyruar që ti japë këtij fakti cilësimin e duhur juridik. Gjykata çmon

se ekzistenca apo jo e veprave penale të parashikuara nga nenet 199/a, 199/b të Kodit Penal apo neni 150 i Kodit Penal rezulton vetëm pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të përmendura më lart apo edhe të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme pas kryerjes së tyre. Vetëm pas kryerjes së tyre mund të arrihet në një konkluzion të drejtë dhe të bazuar për mënyrën e përfundimit të procedimit penal [...]. Më datë ****12.2017** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë i drejtohet Prokurorisë Vlorë duke i përcjellë kopje të njehsuar të vendimit penal nr. *******, datë ****06.2017** me palë ankuese shtetasin ***** *****. Më datë ****2.2018** subjekti nxjerr urdhrin për rifillimin e hetimit të procedimit penal, më datë ****4.2018** nxjerr vendimin për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit, më datë ****6.2018** nxjerr vendimin për marrjen e akteve të procedimit penal lidhur me një akt ekspertimi, më datë ****11.2018** i drejtohet gjykatës me kërkesën për pushimin e çështjes.

6.1.3. Më datë ****3.2019** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ******* ka vendosur [...] **rrëzimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal me nr.*****, të vitit 2018, kthimin e akteve të procedimit penal me nr. ******** të vitit 2018 prokurores znj.Elona Alvora duke urdhëruar kryerjen e këtyre veprimeve procedurale (i) regjistrimin në regjistrin e veprave penale të emrit të personit juridik “****” shpk në cilësinë e personit që i atribuohet vepra penale, (ii) formulimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur të personit juridik “****” shpk për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm” në tokë të tjetrit parashikuar nga neni 192/a/2 i Kodit Penal.[...], i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin datë ****6.2019**, me numër *******. Më datë ****10.2019** subjekti nxjerr urdhrin për rifillimin e hetimit të procedimit penal, më datë ****11.2019** merr vendim për marrjen e personit si të pandehur, më datë ****12.2019** subjekti i rivlerësimit bën kërkesën për gjykimin e çështjes ku kërkon gjykimin e procedimit penal me nr. ******* të vitit 2015 me të pandehur ***** ***** dhe shoqëria “****” shpk akuzuar për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” në tokë të tjetrit parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal.

6.1.4. Më datë ****12.2019** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ****_***-***** ka vendosur pranimin e kërkesës, ndër të tjera arsyeton: [...] Nisur nga sa më sipër dhe për të gjitha arsyet e përmendura në mënyrë shteruese në vendimin nr. ******* datë *****.3.2019** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (me të cilin është vendosur urdhërimi i organit të prokurorisë për formulimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur), gjykata vlerëson se, në rastin konkret, hetimet në ngarkim të pandehurve ***** ***** dhe shoqërisë “****” sh.p.k., janë të plota, nuk konstatohen akte procedurale absolutisht të pavlefshme dhe akuzat e ngritura në ngarkim të secilit të pandehur, nga pikëpamja e cilësimit juridik të faktit penal, janë të sakta dhe në përputhje me ligjin dhe në këto rrethana, kërkesa e

paraqitur nga ana e organit të akuzës, për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. *** të vitit 2018, është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar [...].

6.1.5. Më datë ****05.2021** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. *** ndër të tjera, arsyeton se pjesa prej 50 metër linear rrugë e devijuar nga projekti nuk mund të konsiderohet shkelje e rëndë ka shpallur të pafajshëm të pandehurit, **vendim i cili ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit.**

6.2. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, evidentohen mangësitë profesionale sipas atyre çështjeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 9.8.2022.

7. Në lidhje me **kallëzimet penale regjistruar me nr. ***, viti 2020 dhe nr. ***, viti 2021**, të shtetasve *** dhe *** *** për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale*”, parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 09.08.2022, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë çështje për sa i përket: (i) në drejtim të verifikimit nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal, të filluar në muajin korrik 2020 deri aktualisht⁶, janë apo jo në përmbushje të standardeve të nenit 73 pika 2 të ligjit me nr.96/2016, i ndryshuar, për sa i përket *aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime*; (ii) referuar gjendjes së akteve në dosje të Komisionit, të cilat janë ato të paraqitura nga denoncuesi apo vetë subjekti i rivlerësimit, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë⁷, si dhe *prima facia*, këto vonesa për shkak të llojit të veprës penale kundërvajtje penale, çojnë në parashkrimin e ndjekjes penale.

7.1. Referuar akteve të administruara lidhur me materialin kallëzues me nr. ***, viti 2020 të shtetasit *** ***, rezulton se më datë ****12.2020** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. *** ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit të çështjes për mosfillim të procedimit penal referuar kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2020, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore. Gjykata e Apelit Vlorë pas ankimit të prokurorit më datë ****3.2021** ka vendosur mospranim të ankimit. Subjekti i rivlerësimit më datë ****1.2022** ka nxjerrë aktin urdhër për regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale*”, parashikuar nga neni 149/a/1 i Kodit Penal.

⁶ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit datë **4.2022, statusi i çështjes është në proces hetimi.

⁷ Nga aktet në dosje të Komisionit konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë me nr. **, datë **03.2021 është përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë më datë **12.2021, si dhe me shkrim dore është vendosur numri ***, **12-2021.

7.2. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij duke e regjistruar procedimin penal më datë **.1.2022 për veprën penale parashikuar nga neni 149/a/1 i Kodit Penal duket se ka disponuar për të hetuar për figurën e veprës penale të kundërvajtjes penale që parashikon masë dënimi gjobë ose me burgim gjer në një vit. Marrë në konsideratë se ngjarja objekt kallëzimi ka ndodhur më datë **.7.2020 dhe veprimet e ndërmarra nga subjekti rivlerësimit përmes ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe kohës së regjistrimit të procedimit penal më datë **.1.2022, rrethanat e çështjes do të sillnin në fokus eventualitetin e zbatimit të parashikimeve të nenit 66 të Kodit Penal lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale.

7.3. Referuar akteve të administruara lidhur me materialin kallëzues me nr. ***, viti 2021 të shtetasit *** ***, rezulton se më datë **.10.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. *** ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit të çështjes për mosfillim të procedimit penal referuar kallëzimit penal nr. *** të vitit 2021, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. ***/* Prot., datë **.3.2022 informon se kjo dosje në këtë datë ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë në bazë të ankimit të paraqitur nga Prokuroria Vlorë. Subjekti i rivlerësimit më datë **.10.2022 ka nxjerrë aktin urdhër për regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a/1 i Kodit Penal, më datë **.4.2022 ka nxjerrë urdhër për delegimin e veprimeve hetimore.

7.4. Më datë **.10.2022 subjekti ka nxjerrë vendimin për bashkimin e procedimeve penale, gjatë periudhës kohore 2023-2024 janë administruar përgjigje nga organe shtetërore si dhe janë mbajtur procesverbale nga oficer të policisë gjyqësore për marrje të dhënash nga persona që kanë dijeni për veprën penale.

7.5. Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, evidentohen mangësitë profesionale sipas atyre çështjeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 9.8.2022.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Adnan XHOLI